

Prend BUZHALA

POETIKA E VUAJTJES SË DASHURISË

(Besim Xhelili: "Dallgë në zemër", poezi, 2016)

Të njëqind e tetëdhjetë e tri njësitë strofike me temë dashurinë në lirikat e vëllimit "Dallgë në zemër", poeti Besim Xhelili i përkufizon me shenjën autoriale "183 lirika të dhimbshme dashurie". Si është e mundshme që pikërisht emocioni më sublim i qenies njerëzore ngërthyeka dhe vuajtjen, dhembjen? Kjo tematikë e shndërruar tashmë në obsesion krijues, te libri i Besimit, posi te tema e librit të dytë të Komedisë Hyjnore të Dantes, Purgatori, përpiqet ta japë këtë përgjigje, gjithnjë në universin e erosit, në hapësirat e këndimit lirik mbi dashurinë.

1. Lirika e dashurisë mes vuajtjes dhe dritësimeve

Kësisoj, edhe këtë lirik-, që është një poemë e gjatë liriko-epike, po e lexojmë si hapësirë purgatoriane spastrimesh për të qëndruar tek pastërtia e kësaj ndjesie. Sikur ky emocion u shenjtëruaka vetëm nëpërmes dhimbjes e vuajtjes!

Edhe tri njësitë poetike mbajnë shenja të tilla tematike-lirike. "Ah, digjem natën, asnjë rrugë, asnjë s'kam... /Sot asnjë rreze agimore nuk drodhi arsyen!" (pjesa I); "S'po arrij rrugën andej nga dëshirat anojnë, /Sikur asgjësohem, rrudhat aty n'ballë dhimbjen arnojnë..." (pjesa II) dhe "Si aktor rrugësh atë natë dashurinë aktrova, / Si ashik rrëmbyeshëm akullin në dorë afrova..." e që ngërthejnë dhe funksionin e stilistikës ciklike-kompozicionale të këtij vëllimi. Subjekti lirik i këtij vëllimi dëshiron të na thotë se dëshira e gjakimi për përsosmëri nëpërmes dashurisë dhe lektisjeve të saj, nuk mungojnë në këtë jetë, deri në frymën e fundit, e që na është një si qëllim final i jetës.

Këtë shenjë poetike të vuajtjes, e miraton, prandaj poeti që në fillim:

*Shumë herë zemrën ma rëndon kënaqësia
Rrugës së vetmisë m'shoqëron vetëm mërzia,
Një engjëllushë m'i mori shpirtin dhe këto mend
Ajo larg tretet, unë varrit tim ia kërkoj një vend...*

Do të thotë se vuajtja e dhimbja e tillë purgatoriane danteske, ndryshon rrënjësisht nga ajo e ferrit, ku vuajnë shpirtrat e ligë, një si mallkim të përhershëm. E pra, vuajtja e tillë nuk shpallet e përhershme (si Ferr, për gjykim hyjnor), por e përkohshme për pastrim. Sado që e lexojmë aty-këtu fjalën mallkim:

*Jam i lodhur nga ky mallkim i kësaj dashurie
Kur lotët më bien, s'ta tregoj dot se sa më dhemb...*

menjëherë, aty për aty, subjekti i kësaj drame të vuajtjes nuk dorëzohet, sepse gjakon të bukurën, qetësinë, lumturimin:

*Ah, moj mike, vetes nuk i dëshiroj asgjë më shumë
Me ty nën dritën e hënës të bëjmë qetë një gjumë...*

Madje, te njësia 25 strofike ai e shpall se “Nuk më zmbrafs fuqi e mallkimeve”.

Duke e orkestruar poezinë e tillë nëpërmes një regjistri të gjerë leksikor, si vuajtje, dhimbje, ftohtësi, mërzë, ditë e zyrtë, ditë e hidhur, etj., të duket sikur kjo qenie ka krijuar një labirint vuajtjesh, në të cilin është futur ndërgjegjshëm e pavullnetshëm. Poeti nuk ka si ta dashurojë dhimbjen apo vuajtjen... ai dashuron dashurinë! I ligjëron zemrës së tij se ai i shkon në takim kërkimit të kësaj ndjesie për shpëtim: po qe se e godet kjo dhimbje, po qe se ajo e lëndon edhe së brendshmi, shpirtërisht, atëherë personazhi lirik e ka të qartë se nga situata e tillë ai del më i fortë. Madje, së bashku me protagonistin lirik, vuan edhe e dashura, femra, të cilës i drejtohet gjithnjë folësi lirik i kësaj poezie, të cilës i bën thirrje të dalë edhe më e fortë nga loti, malli, vuajtja:

*Teksa gjuhën ky varg si zjarr ma përshkon
Buzën tënde ndoshta një lot malli e viziton,
Mike e lezetshme, bëhu e fortë e mos vuaj
Si të shpëtoj më të dy, të lutem më thuaj?!*

E pra, kjo botë e vuajtjes, e dhimbjes, nga njëra anë, si dhe hapësirat e dritësimeve, lumturimeve, si kontrastim i gjendjes së parë, nga ana tjetër, e popullojnë tërë këtë vëllim. Atribute të kësaj ftese janë guximi,

solidarësia, mirësia, mëshira, qetësia, durimi... E po, nëse nuk e përjeton dhembjen, si do ta përjetosh gëzimin (“A është mëkat dikë ta bësh të gëzuar?!/ S’më duket si miqësi më e mirë n’botë kjo”). Kurse vuajtja është një medium emocional, jetësor dhe refleksiv, nëpërmes të cilës shfaqet drita. Dhimbja është një mësuese e jetës (“Moj mike, jam mësuar të lëndohem”); nëpër këso lëndimesh ai shfaqet më i fortë (“Ma copëto zemrën se do ta përballoj”); kujtesa e shoqëron si shteg shpëtimi (“Sa herë me shpirtin fytit i afrohem/ Kujtoj sytë e tu dhe kështu shpëtoj”), kurse nëpërmes kësaj kujtese-dhimbjeje, shfaqet gjithnjë edhe një dritë. Një dritë që dhuron gëzim të përhershëm. Ka dritë hëne, por ka dhe dritë syri (“Do të jem i lumtur, n’sytë e tu një dritë e gjej...”). Duke buruar nga dhimbja, kjo dritë shqiptohet si hir i perëndishëm:

*O dritë e shenjtë, dua mos të vuaj
Por, më shumë dua ti mos vuash,*

E tërë qenia është e dhënë pas lektisjeve të dashurisë. Përgjërimet e tilla janë të shumta: “Këtë dallgë përvëluese dhe pafund/Si nyje në gjoks përjetë do ta mbaj.”

2. Relievime dhe këndvështrime estetike dhe semantike

Ndërkaq, cak i vazhdueshëm e i përhershëm estetik e lirik i këtij krijuesi, mbetet magjia e erotizmit dhe dashurisë. Kësisoj, sikur poeti dëshiron ta thurë një sistem të poetikës së tij të dashurisë, me të tri përmbledhjet e fundit poetike dhe me romanin e tij. Hapësirat e tilla estetizuese të dhimbjes së dashurisë, sikur duan ta mbysin a ta krijojnë një gjendje shurdhimi për jehonën e mesazheve që buron nga vargjet. Klithja e lektisja e tillë arrin deri te niveli i një bote pothuajse të pakuptimtë. E, megjithatë, ndjesia e vetmisë dhe e trishtimit që buron nga njëra njësi strofike te tjetra, dhuron kontraktime të bukura figurative-semantike, drithërima të ndjenjës, bukurinë e ndjelljes së të bukurës dhe harmonisë, konstruksione e kontrapunkte gjithë përjetim të ecurisë së strukturimeve lirike: ka një kërkim virgjërie të shpirtit, një virgjëri të plagosshme, pa rënë në nivele të instinktit të verbër. Poeti nuk pikësynon mistere për ta fshehur kuptimin e jetës, por ato i jep të drejtpërdrejta, me anë të një komunikimi të sigurtë mes dy qenieve të dashuruara, femrës dhe mashkullit. Gjithçka zhvillohet në mirësi, fisnikëri, heshtje, vetmi, lektisje dhe përgjërim. Poeti

iu ikën edhe tipit të lirikës rrëfyese, por ai nuk e pikësynon as lirikën enigmatike të labirinteve të fatit... Edhe kur ligjëron për fatalitetin e tillë, fati jep i destinuar nga një forcë supreme:

*Mos u lëndo nëse ditët më ngatërrohen
Kështu ndoshta Zoti fatin ma ka dëshiruar,
Mos lejo sytë e tu t'bukur nga unë të ftohen
Ato m'freskojnë e m'japin forcë për të jetuar...*

Kësisoj, lirika e tillë nuk del e shtresuar dhe e nuancuar përtej skemës që ka ndërtuar autori... por del e pasur me kërkime të kësaj lektisjeje dhe dhimbjeje, me kërkimet për lumturim, qetësi dhe dritë, për fisnikërim të qenies. Prandaj, personazhi i dashuruar i kësaj lirike, na ligjëron se më shumë duhet t'i shohim frytnimet e veprim-reflektimeve e përjetimeve nga këndvështrimi i vuajtjes së tij, sesa nga ai i veprimeve të tij.

Relievi i kësaj poetike të dashurisë përshkohet nga këndvështrime të shumëfishuara. Këndvështrimi i tillë ndjell eupatinë, bashkëndjesinë, mirëkuptimin, besimin, lumturimin, gëzimin, sinqeritetin... ashtu sikundër na e vë përpara në tryezë vuajtjen e dhimbjen, pikëllimin dhe vajin, mërzinë dhe ftohtësinë, lotin dhe vetminë... Vijnë kërkesat për durim, qëndresë, dinjitet, dëshirë,... Aty na vijnë dhe sublimimet tjera semantike të kësaj lirike: koha dhe përvoja, urtia dhe ndryshimi. Dhe, gjithsesi, si cak estetik, aty na e shtrijnë dorën e vet e bukura, përjetimi dhe orkestrimi metaforik i këtyre përgjërimeve. Në këtë orkestrim marrin pjesë trup dhe shpirt, Vetvetja dhe Tjetra, prani dhe mungesë, e rëndomta dhe magjia, strukturë dhe figurë - si shenja të realizimit genieplotë të dashurisë.